



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 589 Akti

Nr. 532 Vendimi
Tiranë, më 18.5.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesve ndërkombëtarë Theo Jacobs dhe Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 16.5.2022, ora 15:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla ovale, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore në lidhje me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Esmeralda Ndoci**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përfaqësuar me prokurë nr. 1259/273, datë 26.8.2021, nga av. A.S.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Esmeralda Ndoci, gjatë periudhës së fillimit të rivlerësimit kalimtar ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.

2. Në datën 12.11.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” Komisioni zhvilloi procedurat për shpërndarjen e çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se procesi i rivlerësimit për subjektin Esmeralda Ndoci do të kryhej nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Pamela Qirko dhe Roland Ilia. Relator i çështjes me short u zgjodh komisionere Brunilda Bekteshi.

3. Me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, trupi gjykues vendosi fillimin e hetimit administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Pamela Qirko.

4. Në datën 22.7.2020, subjekti u njoftua nëpërmjet postës elektronike mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, përbërjen e trupit gjykues, si dhe të deklaronte konfliktin e interesit me anëtarët e tij.

5. Në datën 2.9.2020, Komisioni njoftoi subjektin përmes postës elektronike: (i) se anëtari i trupit gjykues, komisioneri Roland Ilia kishte paraqitur dorëheqjen e tij nga procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Esmeralda Ndoci; si dhe (ii) për procedurën e ndjekur për zëvendësimin e anëtarit të dorëhequr. Po në këtë komunikim, subjekti u njoftua se me vendimin nr. 50, datë 28.7.2020, Komisioni kishte ngritur trupin gjykues që mori në shqyrtim kërkesën e komisionierit Roland Ilia, duke vendosur pranimin e saj dhe zëvendësimin me anëtarin zëvendësues për trupin gjykues, komisioneren Xhensila Pine. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

6. Në datën 19.11.2020, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike: (i) se nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit me asnjërin nga anëtarët e trupit gjykues; (ii) parashtroi arsyet se përse ka qenë në pamundësi absolute dhe objektive për të marrë njoftimin dhe për t’u përgjigjur *e-mail*-eve të Komisionit, duke informuar se me vendimin nr. ***, datë 15.1.2020, nga Këshilli i Lartë të Prokurorisë i është dhënë leje pa të drejtë page¹ për një afat kohor për dy vjet nga 1.2.2020 – 2.2.2021, për arsye familjare, konkretisht për të ndjekur bashkëshortin, i cili punon në një projekt të Bashkimit Evropian në ***, Afrikë; dhe se nuk ka mundur të aksesojë adresën e saj të punës, me gjithë përpjekjet e bëra edhe nëpërmjet kolegëve apo IT-së së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër; (iii) depozitoi një kërkesë paraprake për konstatimin e moskompetencën lëndore të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për fillimin e procedurës administrative të rivlerësimit kalimtar, duke vijuar në kërkimin e saj se në rast se Komisioni vlerësonte se kërkesa është e pabazuar në ligj dhe vendoste që Esmeralda Maillard (Ndoci), është subjekt i procesit të rivlerësimit, kërkonte t’i lihej një afat i arsyeshëm për kthimin e përgjigjeve të formularit, duke marrë në konsideratë largësinë e saj jashtë vendit.

7. Në datën 5.10.2021 përfaqësuesja e subjektit të rivlerësimit, A.S, informoi Komisionin mbi përfaqësimin që ka marrë përsipër për të kryer për subjektin, nëpërmjet prokurës së posaçme

¹Dokument i depozituar nga subjekti, po me këtë *e-mail*.

nr. ****, datë 26.8.2021, të cilën e ka depozituar, si dhe kërkoi shtyrje të afatit për dërgimin e përgjigjeve të pyetësorit standard edhe me 10 ditë, si dhe vijimin e komunikimit respektiv të Komisionit edhe në adresën e saj si përfaqësuese e çështjes. Komisioni i komunikoi² përfaqësueses ligjore (në vijim përfaqësueses) të subjektit shtyrjen e afatit me 10 ditë të tjera për të depozituar përgjigjet e pyetësorit standard.

8. Në datën 16.10.2021, përfaqësuesja e subjektit të rivlerësimit ka depozituar³ përgjigjet e pyetësorit standard, si dhe dokumentacionin mbështetës. Njëkohësisht të njëjtin material e ka dërguar edhe nëpërmjet shërbimit postar.

9. Në datën 14.12.2021, përfaqësuesja ka kërkuar⁴ përsheptimin e procesit të rivlerësimit për znj. Esmeralda Maillard (Ndoci) dhe për këtë ka depozituar edhe kërkesën⁵ e arsyetuar, bazuar në nenin 8⁶ të KEDNJ-së, në nenin 53⁷ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin G të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit në këtë kërkesë ka kërkuar: (i) përfundimin e procesit të rivlerësimit deri në datën 31.12.2021; ose (ii) përsheptimin dhe përfundimin e procesit të rivlerësimit ndaj saj, brenda një afati të shkurtër kohor me qëllim që të mos i cenohet e drejta për një jetë familjare.

9.1 Subjekti, për të bërë të mundur pranimin e kërkesës, ka parashtruar si argument: (i) faktin se prej dy vjetësh qëndron jashtë vendit pranë bashkëshortit të saj, mundësuar kjo, pas marrjes së një leje të papaguar 2-vjeçare të miratuar nga KLP-ja me vendimin nr. ***, datë 15.1.2020, e cila i përfundonte më 31.1.2022; (ii) shprehjen e vullnetit të saj për t'u vetuar dhe jo për t'iu shmangur procesit; si dhe (iii) faktin se dhënia e dorëheqjes, sipas parashikimit të bërë në neni G të Aneksit të Kushtetutës, shoqërohet me mosushtimin e detyrës për 15 vjet, duke theksuar se për të qëndruar pranë bashkëshortit të saj i duhet të japë dorëheqjen.

10. Në datën 20.12.2021, Komisioni i ka konfirmuar⁸ subjektin dhe përfaqësueses së saj se në vijim të kërkesës për përsheptim të procesit të rivlerësimit do të njoftohet lidhur me qëndrimin e mbajtur, me marrjen e kërkesës në shqyrtim, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

11. Në datën 24.2.2022, Komisioni ka njoftuar⁹ subjektin dhe përfaqësuesin se procesi i rivlerësimit ndaj saj do të shqyrtohet/përfshihet si dosje me prioritet në shortin përkatës.

12. Në datën 25.3.2022, Komisioni ka administruar¹⁰ vendimin nr. ***, datë 24.2.2022, të KLP-së me të cilin është vendosur *deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për znj. Esmeralda Ndoci, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shkak të dorëheqjes*, vendim në të cilin, gjithashtu, janë pasqyruar efektet e tij, si dhe njoftimet përkatëse.

²Me e-mail-in datë 6.10.2021.

³Me anë të postës elektronike.

⁴Me anë të postës elektronike.

⁵Nënshkruar në datën 10.12.2021.

⁶Neni 8 i KEDNJ-së parashikon: 1. *Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.* 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

⁷Neni 53 1. *Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje.* 2. *Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.* 3. *Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj.*

⁸Me anë të postës elektronike.

⁹Me anë të postës elektronike.

¹⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2022, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 25.3.2022.

13. Komisioni, pas kërkesës drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, u informua¹¹ se subjekti i rivlerësimit nuk kishte ushtruar ankim ndaj vendimit të KLP-së.

14. Në datën 26.4.2022, Komisioni në mbështetje të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, i ka kërkuar¹² subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësueses së saj të shprehen lidhur me ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore. Përfaqësuesja e subjektit të rivlerësimit njoftoi¹³ Komisionin se dëshironte të dëgjohej në seancë dëgjimore.

15. Në datën 5.5.2022, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të ndërpresë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Esmeralda Ndoci; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, duke i vendosur në dispozicion materialin përkatës; (iii) të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë pretendimet e tij brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike.

16. Po në datën 5.5.2022, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit të cilat konsistojnë në efektet ligjore që jepte dorëheqja e subjektit të rivlerësimit; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës së seancës dëgjimore e parashikuar për t'u mbajtur në datën 12.5.2022. Përfaqësuesja e subjektit të rivlerësimit paraqiti në seancë dëgjimore shpjegimet/qëndrimin e saj mbi rezultatet e hetimit administrativ.

17. Në datën 6.5.2022 përfaqësuesja e subjektit të rivlerësimit ka kërkuar të njihet me dokumentacionin e plotë (*edhe në mënyrë elektronike*), që i përket subjektit të rivlerësimit, lidhur me të tria kriteret e rivlerësimit, kërkesë e cila është pranuar dhe njëkohësisht subjekti është njoftuar për të aksesuar të gjithë dokumentacionin e administruar në dosje, e drejtë që nuk u ushtrua nga ana e përfaqësueses.

18. Në datën 10.5.2022, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Esmeralda Ndoci, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke njoftuar në të njëjtën datë subjektin, me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 12.5.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

19. Në datën 11.5.2022, përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit depozitoi kërkesë për shtyrje të seancës dëgjimore, me argumentin se ishte përfaqësuese e një personi nën hetim, gjykimi i të cilit bëhej në të njëjtën datë me atë të seancës dëgjimore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kërkesë e cila është pranuar dhe për të subjekti është njoftuar në mënyrë elektronike në datën 12.5.2022 se seanca do të zhvillohej më 16.5.2022, ora 11:30. Po në këtë datë, me anë të postës elektronike, Komisioni njoftoi përfaqësuesen e subjektit, lidhur me të drejtën e aksesimit të akteve të dosjes së hetimit për të tria shtyllat e hetimit deri në këtë fazë.

20. Në datën 12.5.2022 përfaqësuesja e subjektit të rivlerësimit ka njoftuar se ishte në pamundësi të zhvillimit të seancës në datën 16.5.2022, ora 11:30, për shkak të pjesëmarrjes në një gjykim në të njëjtën orë dhe për këtë ka depozituar fletëthirrjen për gjykim, si dhe kalendarin e gjykimeve të planifikuara.

¹¹Me shkresën e datës 8.4.2022.

¹²Me anë të postës elektronike.

¹³Me anë të postës elektronike në datën 28.4.2022.

21. Trupi gjykues, me vendimin nr. 4, datë 12.5.2022, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Esmeralda Ndoci, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke njoftuar në të njëjtën datë subjektin me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 16.5.2022, ora 15:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

22. Në vijim, në datën 13.05.2022, Komisioni ka njoftuar me anë të postës elektronike përfaqësuesen e subjektit se në rrethanat e paraqitura të kësaj çështjeje, nuk mund të vazhdojë të tolerojë shtyrjen e seancave vijuese, si dhe për paraqitjen e saj për akses në aktet e dosjes për të tria shtyllat e rivlerësimit, edhe pse Komisioni kishte konstatuar se ky kërkim i saj, nuk dukej se lidhet me rezultatet e hetimit të dërguara, të cilat konsistonin në efektet ligjore që jepte dorëheqja e subjektit të rivlerësimit. Në datën 14.5.2022, Komisioni njohu përfaqësuesen e subjektit me aktet e dosjes përmes postës elektronike.

II. Ftesa për seancë dëgjimore dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

23. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 16.5.2022, në orën 15:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0 dhe salla ovale, në prani të subjektit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

24. Subjekti i rivlerësimit u përfaqësua me avokat, i cili mori të gjithë kohën e duhur për të parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit.

25. Përfaqësuesja ligjore, në datën 16.5.2022, sipas kërkesës së trupit gjykues paraqiti pranë sekretarisë gjyqësore materialin mbrojtës, shprehur në seancë, të cilat u administruan në dosjen e subjektit të rivlerësimit.

26. Në përfundim të procesit të kryer ndaj saj, subjekti i rivlerësimit kërkoi që Komisioni të deklarojë që nuk ka kompetencën dhe ta përfundojë pa vendim procesin e rivlerësimit ndaj znj. Esmeralda Ndoci dhe si kërkesë alternative, nëse Komisioni e përfundon procesin e rivlerësimit ndaj saj, për shkak të dorëheqjes, të mos aplikojë nenin, sanksionin e parashikuar nga pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

27. Znj. Esmeralda Ndoci ka qenë bashkëpunuese, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. HETIMI I KOMISIONIT MBI AKTIN E DORËHEQJES

28. Komisioni, pas procedurës administrative të mbajtur me subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesen ligjore të saj, përgatiti materialin mbi rezultatet e hetimit të fokusuar në aktin e dorëheqjes së subjektit depozituar përpara KLP-së, vendimin për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, në raport me ligjin nr. 84/2016 dhe nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

29. Në zbatim të këtij legjislacioni, akti i dorëheqjes së subjektit nga detyra e prokurorit, sjell si pasojë humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi (*ex officio*) në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b, pika 4, e Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të

procesit të rivlerësimit, që në referim të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 dhe nenit 58, pika 1/a/b/c, të ligjit nr. 84/2016, përfundon nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit.

30. Në lidhje me situatën ligjore dhe atë faktike të subjektit Esmeralda Ndoci, dukej se Komisioni nuk kishte më kompetenca ligjore për të vazhduar procesin e rivlerësimit, sepse subjektit të rivlerësimit i mungon cilësia subjektive, e cila është një parakusht për procesin e rivlerësimit, për arsye se subjekti nuk bën më pjesë as në kategorinë e subjekteve që rivlerësohen *ex officio* dhe as të atyre në mënyrë vullnetare, pasi nuk e ka statusin subjektiv, sipas parashikimit të nenit 179/b, pika 4, e Kushtetutës.

31. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk ka shprehur vullnetin për t'iu shmangur procesit të rivlerësimit, procesi i rivlerësimit nuk mund të vazhdohet më pas dorëheqjes së saj nga detyra.

32. Në momentin që subjekti i rivlerësimit Esmeralda Ndoci vendosi me vullnetin e saj të lirë të ndërpriste detyrën e saj funksionale si prokurore, fakt ky që e bënte atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, e vetmja procedurë që mund të ndërmernte Komisioni ka të bëjë me përfundimin e procesit të rivlerësimit, sipas njërës prej mënyrave të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, Kodin e Procedurave Administrative apo edhe në Aneksin e Kushtetutës.

33. Nisur nga tërësia e fakteve të dala deri në këtë fazë të hetimit, dukej se procesi i rivlerësimit për znj. Esmeralda Ndoci, përfundon/ndërpritet në bazë të paragrafit 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës dhe mbi këtë konstatim subjektit i është kërkuar të japë shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

34. Përfaqësuesja e subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, në parashtrimet e saj ka shpjeguar se: *“Emërimi i znj. Esmeralda Ndoci është bërë në bazë të dispozitës kalimtare të ligjit nr. 96/2016, si dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nga Prokurori i Përgjithshëm në atë kohë dhe Presidenti, me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.*

Në momentin kur znj. Esmeralda Ndoci është emëruar prokurore në detyrë kishin hyrë në fuqi ndryshimet ligjore Kushtetuese, sipas ligjit mos gaboj 76/2016, i cili ka hyrë në fuqi në muajin gusht të vitit 2016.

Në momentin që znj. Esmeralda Ndoci është emëruar prokurore, pra, në muajin tetor të vitit 2016, ishte e detyrueshme si kriter për t'u bërë gjyqtar dhe prokuror duhet të plotësoheshin njëkohësisht disa kriteret mospërmbushja e të cilave, përbënte shkak pazgjdhshmërie, sepse dihet që të plotësosh kushtet dhe kriteret për një gjyqtar është shumë e rëndësishme sepse ka të bëjë me procesin e rregullt ligjor.

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në vitin 2016 në momentin që znj. Esmeralda Ndoci është bërë prokurore e Republikës së Shqipërisë dhe shumë magjistrat, pra, të kësaj mature të themi, duhet patjetër që, ndër të tjera, të kishe kaluar rivlerësimin e pasurisë dhe të figurës.

Znj. Esmeralda Ndoci është emëruar prokurore e Republikës së Shqipërisë dhe ka kryer detyrën e prokurores, ashtu si edhe magjistratët e tjerë që janë emëruar në këtë periudhë. Konsiderohet se autoritetet që kanë pasur detyrimin për ta emëruar kanë kryer procesin e rivlerësimit të figurës dhe të pasurisë dhe, për këtë arsye, Komisioni nuk ka pasur detyrimin

dhe kompetencën, që të kryejë rivlerësim ndaj këtyre magjistratëve, ashtu siç kryhet tani më në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për magjistratët të cilët mbarojnë Shkollën e Magjistraturës përpara se të emërohen.

Për këtë kategori magjistratësh mendoj që ligji kishte parashikuar një mënyrë ndryshe të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ishte në diskrecion të autoriteteve të kohës, sipas dispozitave kalimtare që të kryenin procesin e rivlerësimit ndaj znj. Esmeralda Ndoci.

Znj. Esmeralda Ndoci i është drejtuar Komisionit me kërkesën për shpalljen e moskompetencës lëndore, duke kërkuar të deklarohet shpallja e moskompetencës lëndore të Komisionit dhe kjo procedurë të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar. Për këtë kërkesë, Komisioni nuk ka kthyer përgjigje në kundërshtim me parashikimet e bëra në Kodin e Procedurës Administrative.

Pavarësisht këtij qëndrimi që ndan ndaj kompetencës së Komisionit, znj. Esmeralda Ndoci i është nënshtruar procesit të rivlerësimit dhe është shortuar.

Komisioni për kandidatët magjistrat të emëruar në vitin 2016 në disa vendime ka mbajtur qëndrimin se ata janë subjekt rivlerësimi ex officio.

Znj. Esmeralda Ndoci ndan vlerësim të kundërt, prandaj insiston në qëndrimin e saj, por në kushtet kur ka një praktikë të veçantë të vendosur nga Komisioni ka vlerësuar se kthimi i përgjigjeve dhe vazhdimi i procesit ishte e vetmja mënyrë për ta ankimuar vendimin e tij, për qëndrimin e gabuar të mbajtur, pra, konsiderimi i kandidatëve për magjistratë si subjekt rivlerësimi.

Znj. Esmeralda Ndoci ka pranuar t'i nënshtrohet këtij procesi si e vetmja mundësi për ta ankimuar vendimin përfundimtar, nëse ai do të jetë njësoj si praktika e mbajtur deri tani nga Komisioni.

Në datën 21.2.2020, znj. Esmeralda Ndoci ka lidhur martesë me z. V.V, i cili është shtetas francez. Për arsye familjare, mbi bazën e kërkesës së saj, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin përkatës ka miratuar lejen e papaguar për një afat 2-vjeçar, leje e cila përfundonte më 31.1.2022. Në datën 10.12.2021, znj. Esmeralda Ndoci ka kërkuar përshpejtimin e procesit të nisur ndaj saj, duke kërkuar përfundimin e procesit administrativ të nisur ndaj saj deri në datën kur mbaronte leja ose përshpejtimin dhe përfundimin e procesit ndaj saj brenda një afati të shkurtër kohor, me një qëllim që të mos cenohet e drejta e saj për një jetë familjare.

Kërkesa është bazuar në nenin 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe në nenin 53 të Republikës së Shqipërisë, për shkak se ka parashtruar faktin se prej 2 vjetësh qëndron jashtë vendit pranë bashkëshortit, mundësuar kjo pas marrjes së një leje të papaguar 2-vjeçare, ashtu siç e thamë edhe më sipër dhe shprehjen e vullnetit të saj për mos iu shmangur procesit. Faktin se dhënia e dorëheqjes sipas parashikimit të bërë në nenin G të Aneksit të Kushtetutës shoqërohet me mosushtrimin e detyrës për 15 vjet, duke theksuar se për të qëndruar pranë bashkëshortit i duhet të japë dorëheqjen dhe nëse do të aplikohet ky sanksion i parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës ajo vlerëson që kjo gjë nuk është proporcionale me kushtet e saj, me qëllim që nga njëra anë ajo të realizonte të drejtën e saj për një jetë familjare sipas nenit 8 të Konventës dhe nga ana tjetër të ndiqte rrugën ligjore të kishte një vendimmarrje ndaj kërkesave të saj, ka pranuar të kufizoj të drejtën e saj për të mos punuar në shtetin ku jetonte pranë bashkëshortit, si dhe të drejta të tjera të cilat i kufizohen për shkak të statusit të

magjistratit, pra, vetëm e vetëm që të mos i shmangesh procesit ka marrë leje të papaguar, ka shkuar pranë bashkëshortit, ka qëndruar 2 vjet pa punë, ka respektuar të gjitha detyrimet e magjistratit vetëm e vetëm me kushtin e vetëm që të mbaronte procesi i rivlerësimit ndaj saj.

Në momentin kur znj. Esmeralda Ndoci ka marrë lejen e papaguar ka vlerësuar se afati 2-vjeçar, që ajo shfrytëzoi sipas ligjit nr. 96/2016 ishte i mjaftueshëm që procesi i rivlerësimit të përfundonte, duke pasur parasysh faktin se sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në momentin kur ndërmoi këtë veprim Komisioni e kishte afatin 5-vjeçar dhe pak a shumë ajo vlerësonte që procesi i saj i rivlerësimit brenda asaj periudhe kohore do të kishte përfunduar.

Në momentin kur u njoh me ndryshimet ligjore me projektligjin që kishte mbërritur në parlament për zgjatjen e afatit të Komisionit dhe me vite të tjera kërkoi që të përshpejtonte procesin sipas kërkesave të paraqitura më sipër.

Znj. Esmeralda Ndoci në dhjetor, paraqiti në përfundim të lejes së saj të papaguar kërkesë për të cilën nuk ka marrë përgjigje nga Komisioni edhe pse kishte kaluar 45 ditë nga afat i përcaktuar nga Kodi i Procedurës Administrative për kthimin e përgjigjeve të subjekteve, sepse ne e dimë që Komisioni, ndër ligjet e tjera që zbaton është edhe Kodi i Procedurës Administrative.

Nevojat e saj familjare në përfundimin e afatit të lejes ishin të tilla që nuk e lejonin të vazhdonte detyrën e prokurores për shkak se duhet të jetojë pranë bashkëshortit, i cili jeton dhe është i punësuar në një shtet tjetër, si *** për Policinë Franceze në Europol.

Megjithatë, në përfundim të lejes së datës 1.2.2022, znj. Esmeralda Ndoci është paraqitur në detyrë me qëllim që Komisioni të merrte një vendim apo t'i kthente një përgjigje kërkesave të saj.

Në vijim, në datën 24.2.2022, kur znj. Esmeralda Ndoci ishte kthyer tashmë në detyrë, Komisioni ka njoftuar në adresën e saj elektronike subjektin dhe përfaqësuesen e saj ligjore, pra, mua se procesi i rivlerësimit të saj do të shqyrtohet si dosje prioritare në shortin përkatës, por ky premtim i Komisionit në vlerësim të znj. Esmeralda Ndoci nuk është i saktë.

Këtë përgjigje znj. Esmeralda Ndoci e ka vlerësuar si një refuzim të Komisionit për të marrë një vendim përfundimtar në një kohë të arsyeshme ndaj kërkesave të paraqitura prej saj dhe, si rrjedhojë, këtë mënyrë të vepruari e konsideron si cenim të të drejtave të saj të parashikuara nga neni 6, neni 8 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Edhe pas kësaj përgjigje, Komisioni nuk ndërmoi asnjë veprim që të krijonte bindjen te subjekti se do të trajtohej me prioritet, pra, nuk u dërgua asnjë pyetësor, nga këqyrja e akteve nuk rezulton se pas kthimit të përgjigjes Komisioni të ketë kryer ndonjë verifikim apo të ketë vënë në lëvizje procesin për të krijuar bindjen te kërkuesja se do ta trajtonte çështjen vërtetë me prioritet, të paktën tani e tutje.

Komisioni nuk ka pasur asnjë ndalesë ligjore, madje, përkundrazi ka qenë i detyruar të zbatoj parimet dhe të drejtat kushtetuese, konventore të znj. Esmeralda Ndoci, si dhe parashikimet ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, ligjit nr. 84/2016, si dhe Aneksit të Kushtetutës.

Znj. Esmeralda Ndoci ka bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme që të respektojë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 84/2016 të gjyqtarëve, si dhe ligjin nr. 96/2016”.

35. Më tej, përfaqësuesja ligjore ka parashtruar se znj. Esmeralda Ndoci në të gjitha kërkesat e paraqitura prej saj dhe dokumentet e depozituar pranë Komisionit nuk ka pasur asnjë qëllim

për t'iu shmangur procesit të rivlerësimit, përkundrazi ka bërë të gjitha përpjekjet që të përfundonte procesin e rivlerësimit brenda një afati të arsyeshëm pa cenuar të drejtat e saj themelore. Përfaqësuesja ka referuar nenin 26 të Kushtetutës, nenin 38, ku parashikohet se kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin dhe të lëviz lirisht, si dhe nenin 53, ku parashikohet që kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti.

35.1 Bazuar në faktet e sipërcituara si në interpretim të dispozitave Kushtetuese të sipërcituara rezulton që procesi i rivlerësimit ndaj znj. Esmeralda Ndoci duhet të ndërpritet pa u aplikuar sanksioni i parashikuar në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, për shkak se nuk është subjekt i procesit të rivlerësimit *ex officio*, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës dhe së dyti ka kryer të gjitha përpjekjet që organet e rivlerësimit të përfundojnë procesin administrativ të nisur ndaj saj dhe ka treguar, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se nuk ka pasur asnjë qëllim për të mos iu shmangur këtij procesi, si dhe ka shteruar të gjitha mundësitë ligjore për të mos iu shmangur procesit.

36. Gjithashtu, përfaqësuesja ka referuar në funksion të shpjegimit të saj, vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit për subjektin e rivlerësimit G.S, në të cilin shprehej se subjektet kanë në dispozicion disa mjete të tjera, siç janë leja e papaguar në rastin konkret, ku ai pretendonte që dorëheqja ishte për arsye shëndetësore dhe Kolegji i ka arsyetuar në mendimin e tij që në rastin konkret subjekti duhet të kishte shfrytëzuar lejen e papaguar. Në fakt, znj. Esmeralda Ndoci i ka shfrytëzuar të gjitha hapësirat ligjore, kur i ka shteruar të gjitha hapësirat ligjore në kushtet e mosveprimit të Komisionit ka vendosur të japë dorëheqjen e detyruar nga të gjitha rrethanat që u parashtruan.

37. Në këto kushte, bazuar në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 8 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, përfaqësuesja ka drejtuar kërkesën me qëllim përfundimin e procesit të rivlerësimit ndaj znj. Ndoci dhe mosaplikimin e kufizimeve të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

38. Përfaqësuesja e subjektit të rivlerësimit u është përgjigjur edhe pyetjeve të trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar në seancë dëgjimore. Ndërsa është shprehur se subjekti është vlerësuar nga Prokurori i Përgjithshëm dhe Shkolla e Magjistraturës, është përgjigjur se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar të tre formularët e vlerësimit dhe se nuk ka një akt vlerësimi të mëparshëm ku të rezultojë që subjekti të jetë vlerësuar në të tria kriteret.

39. Në lidhje me pyetjen – në qoftë se ky vendim do ishte marrë një vit përpara, a do ta cenonte jetën familjare të saj qëndrimi në detyrë – përfaqësuesja e subjektit është përgjigjur se: *“Znj. Esmeralda Ndoci i ka shteruar të gjitha hapësirat ligjore ashtu siç dhe Kolegji ka theksuar në vendimin e saj, ka gjetur hapësirën ligjore dhe ka marrë leje të papaguar për të respektuar jetën e saj private, një të drejtë të saj themelore dhe nëse vendimi do të ishte marrë gjatë kohës që ka shfrytëzuar këtë hapësirë ligjore, sigurisht që asaj nuk do t'i ishte cenuar jeta e saj private...në kushtet kur nuk iu dërgua asnjë pyetësor ashtu siç bëhet zakonisht nga Komisioni, ajo e konsideroi që Komisioni nuk kishte ndërmend ta shqyrtonte kërkesën e saj me përparësi dhe, për këtë arsye, zgjodhi që të mos vazhdonte, më tej, vuajtjen e saj duke qëndruar larg bashkëshortit, duke respektuar të gjitha detyrimet e magjistratit dhe do vazhdojë rrugën duke kryer pastaj ankimimet përkatëse pranë autoriteteve”.*

40. Pyetjes së anëtarit të trupit gjykues, se në qoftë se do të shqyrtohej kërkesa me përparësi siç kërkonte subjekti dhe hipotetikisht subjekti do të konfirmohej në detyrë...a do vazhdonte të punonte si magjistrate, përfaqësuesja është përgjigjur: “*Jo, ... sigurisht që jo sepse ajo ka pasur mundësi që të punonte si magjistrate dhe ka marrë leje të papaguar, ka ikur nga detyra*”.

41. Pyetjes se si shqyrtimi me përparësi i një kërkesë nga Komisioni do t’i cenonte jetën e saj private, përfaqësuesja e subjektit iu përgjigj: “*Shqyrtimi me prioritet nuk do ta cenonte, mosshqyrtimi me prioritet i ka cenuar jetën e saj private...*”.

42. Subjekti është përgjigjur mbi këtë proces në raport me përkufizimin e të drejtës familjare, bazuar në pyetjet e parashtruara nga vëzhguesi ndërkombëtar, ku, ndër të tjera, e ka quajtur zgjedhje personale të individit qëndrimin në detyrë apo pranë familjes. Përfaqësuesja ka pretenduar se në rastin konkret sanksioni i vendosur nga neni G i Aneksit të Kushtetutës është një sanksion i jashtëzakonshëm, më i rëndë se sa ato që parashikohen në Kodin Penal, kur kryhen vepra penale, për të mos ushtruar një detyrë të caktuar.

Arsyetimi ligjor në raport me ligjin e zbatueshëm

a. Në lidhje me parashtrimin e subjektit të rivlerësimit se nuk është subjekt rivlerësimi, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe, për pasojë, Komisioni duhet të deklarojë shpalljen e moskompetencës lëndore, si dhe përfundimin e kësaj procedure pa një vendim përfundimtar, trupi gjykues arsyeton duke u bazuar në këtë ligj, si dhe dispozitat ligjore kushtetuese.

a/1. Paraprakisht, trupi gjykues mbi pretendimin e subjektit për moskthim të përgjigjes brenda afatit 45-ditor¹⁴, lidhur me çështjen e kompetencës lëndore, vlerëson se ky pretendim në kushtet e: (i) praktikave të krijuara nga Komisioni¹⁵ me subjekte të tjera, me të njëjtën natyrë çështje dhe pretendimesh; (ii) faktit që vetë subjekti është sjellë si i tillë, duke plotësuar formularët përkatës të kërkuar nga ligji nr. 84/2016; (iii) faktit se në komunikimin e parë që Komisioni ka pasur me përfaqësuesin e subjektit të rivlerësimit është bërë me dije për rolin e saj në këtë çështje dhe kërkimin për lënien e një afati për dërgimin e pyetësorit standard, pa parashtruar rikërkimin e moskompetencës; (iv) paraqitjes së kërkesës së subjektit për përsheptimin e procesit; si dhe (v) trajtimit të kësaj kërkesë në rezultatet e hetimit administrativ, nuk evidenton rrethana për cenimin e të drejtave të subjektit.

a/2. Lidhur me çështjen se znj. Esmeralda Ndoci nuk është subjekt rivlerësimi, sipas ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, në analizë të dispozitave ligjore, frymës dhe qëllimit të tij, arsyeton duke referuar:

a/3. Së pari, ligji nr. 84/2016, në nenin 3/16, ka parashikuar shprehimisht: “*Subjekt i rivlerësimit janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës*”.

a/4. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 179/b/3 dhe 5, të saj ka parashikuar: “*3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio. 5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të*

¹⁴Pretendim për të cilin subjekti nuk referon ndonjë dispozitë konkrete.

¹⁵Vendimet nr. ***, datë 22.4.2021, nr. ***, datë 24.9.2021, nr. ***, datë 25.6.2021, etj.

rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese ...”.

a/5. Në interpretim të këtyre dispozitave, subjekt-objekt i këtij arsyetimi, në përfundim të arsimimit përkatës (për shkak se ishin diplomuar), në kuptim të nenit 160 të ligjit nr. 96/2016, ka gëzuar titullin “magjistrat kandidat” deri në emërimin definitiv si magjistrat. Ndërsa, rivlerësimi i tyre lidhet ngushtësisht me statusin që ajo ka mbajtur përgjatë vitit 2016.

a/6. Legjislacioni i pasqyruar në mënyrë kronologjike qartëson statusin që subjektet gëzojnë në kuptim të përkufizimit “subjekt rivlerësimi”.

a/7. Procesi i rivlerësimit përfshin në objektin e tij gjyqtarët dhe prokurorët, që në këtë rast, subjekti, ka qenë emëruar si e tillë me Dekret të Presidentit nr. ***, datë 7.9.2015¹⁶, si prokuror i përkohshëm në stazh. Po ashtu, subjekti ka ushtruar detyrën e saj duke hetuar, konkluduar, përfaqësuar organin e akuzës apo ndërmarrë vendime përgjatë vitit 2016, të cilat, më pas, kanë qenë ose jo objekt i konfliktit gjyqësor. Trupi gjykues vlerëson se veprimtaria e ushtruar nga subjekti në mënyrë individuale dhe nën përgjegjësitë e dhura ligjore, merr shkas nga qenia e saj magjistrat, duke mos konkuruar thjesht dhe vetëm me termin “kandidat”. Edhe nëse gjatë ushtrimit të detyrës në këto raste mund të jenë trajtuar çështje më të lehta, përsëri ato nuk janë ndikuar në zgjidhje nga fakti që subjekti ka qenë kandidat.

a/8. Në këtë kontekst, trupi gjykues, në referim të detyrimeve të sanksionuara nga dispozitat e Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, të aplikueshme prej momentit të hyrjes së këtij të fundit në fuqi, vëren se neni 179/b i Aneksit të Kushtetutës, në përcaktimin e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*, përfshin të gjithë gjyqtarët, prokurorët dhe kategoritë e tjera, pa bërë asnjë specifikim, ndarje në nënkategori apo dallim midis gjyqtarëve apo prokurorëve në detyrë dhe atyre jo në detyrë. Po ashtu, për sa kohë ky përkufizim i përfshin të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët pa bërë diferencim për ata subjekte me status “kandidat për magjistrat”, ndryshe nga sa parashtron subjekti, trupi gjykues nuk konstaton arsye për të cilat znj. Esmeralda Ndoci nuk do të duhej t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit *ex officio*.

a/9. Në logjikë të këtij arsyetimi ligjor merr peshë edhe fakti se subjekti i rivlerësimit me veprimet e saj është sjellë si i tillë përpara nisjes së procesit të rivlerësimit, duke përmbushur detyrimet e përcaktuara në ngarkim të subjekteve të rivlerësimit *ex officio*, në funksion të mundësisimit të kryerjes së këtij procesi ndaj tyre.

a/10. Në këtë drejtim, subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin e parashikuar në pikën 1 të nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me fillimin e procedurës së vlerësimit të pasurisë, ku parashikohet: “*Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së*”. Subjekti e ka depozituar këtë deklaratë në datën 27.1.2017.

a/11. Subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin tjetër të parashikuar në pikën 1 të nenit 35 të ligjit 84/2016, lidhur me fillimin e procedurës për kontrollin e figurës, ku parashikohet: “*Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për 9 kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgon atë pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar*”. Subjekti e ka depozituar këtë deklaratë në datën 27.1.2017.

¹⁶Depozituar nga subjekti me e-mail e datës 19.11.2020.

a/12. Në vijim të përmbushjes së plotë të detyrimeve ligjore, subjekti ka plotësuar formularin përkatës lidhur me fillimin e procedurës për vlerësimin e aftësisë profesionale, parashikuar në pikën 1, të nenit 41, në të cilin thuhet shprehimisht: “*Subjekti i rivlerësimit plotëson formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale*”. Subjekti i rivlerësimit e ka plotësuar dhe depozituar këtë formular në datën 27.1.2017.

a/13. Faktet e konstatuara rikonfirmojnë edhe njëherë përgjigjen e subjektit (përfaqësueses së saj) në seancë dëgjimore në funksion të pyetjes së anëtarit të trupit gjykues, se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar të tre formularët e vlerësimit dhe se nuk ka një aktvlerësimi të mëparshëm ku të rezultojë që subjekti të jetë vlerësuar në të tria kriteret.

a/14. Trupi gjykues, për këtë çështje, për sa arsyetoi më sipër, vlerëson se znj. Esmeralda Ndoci, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka qenë subjekt që duhej t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit *ex officio* dhe, për pasojë, çështja është në kompetencë shqyrtimi nga Komisioni si institucion i përcaktuar me ligj.

b. Në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përshpejtimin e procesit të rivlerësimit *Vetting*¹⁷ dhe pretendimit të saj se mosshqyrtimi me prioritet i ka cenuar jetën e saj private, trupi gjykues arsyeton si vijon:

b/1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ushtron kompetencat bazuar në ligjin nr. 84/2016 në përputhje me objektin dhe qëllimin e tij.

b/2. Objekt i punës së këtij ligji janë të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët në rang vendi, ndërsa qëllimi është rivlerësimi i tyre në komponentët e parashikuar në këtë ligj, për të garantuar shtetin e së drejtës.

b/3. Në këtë kontekst, ushtrimi i veprimtarisë së Komisionit ndaj subjektit të rivlerësimit Esmeralda Ndoci nuk cenon aspak pikën 1 të nenit 8 të kësaj konvente. Balanca e vlerësuar në këtë rast apo proporcionaliteti i vlerësuar shihet në raport me rregullat e vendosura sa i përket radhës së ndjekjes së procedurave për rivlerësimin e subjekteve dhe përjashtimin nga rregulli.

b/4. Lidhur me rregullin e vendosur cilësohen dy momente:

- i. Ndjekja e radhës në mënyrë të njëpasnjëshme për hetimin e secilit subjekt, që do të thotë ndjekja sipas periudhës në të cilën secili prej subjekteve është shortuar. Në këtë drejtim subjekti i rivlerësimit është shortuar në qershor të vitit 2020, që do të thotë pa përfundimin e shortit të vitit 2019 dhe subjekteve prioritare për shkak të kërkesave të tyre për lëvizje në detyrë, rregulli nuk mund të cenohet.
- ii. Përjashtim nga rregulli bëjnë vetëm subjektet e referuar në pikën 7 të nenit 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, të cilët kanë aplikuar për lëvizje të tyre në gjykatat më të larta apo në organet e tjera të krijuara në sistemin e drejtësisë, të cilët janë kategorizuar si subjekte prioritare dhe, për pasojë, i janë nënshtruar apo i nënshtrohen në vijim me prioritet procesit të rivlerësimit.

b/5. Rasti në fjalë nuk bën përjashtim nga rregulli, përkundër do të dukej si krijim i një precedenti të ri, që në dukje do të krijonte idenë e një mosbarazie mes subjekteve të tjera, nën vlerësimin se

¹⁷ bazuar në nenin 8 të KEDNJ-së, nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin G të Aneksit të Kushtetutës

do të duhej të prevalonte neni 8 i KEDNJ-së. Referencat ligjore të prezantuara nga subjekti (përfaqësuesja e saj) duket se nuk lidhen me kërkimet konkrete dhe as nuk kanë relevancë në këtë proces. Ashtu sikurse subjekti i rivlerësimit kërkon hetimin e tij brenda një afati të arsyeshëm, trupi gjykues vlerëson se nuk mund të cenohet apo thyhet rregulli për të mospërmbushur hetimin brenda një afati të arsyeshëm të subjekteve, të cilët për nga radha janë shortuar më parë në vitin 2019.

b/6. Trupi gjykues vlerësoi se është në zgjedhje të subjektit ushtrimi i lirë i detyrës deri në përfundimin procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj saj, sipas parashikimeve ligjore të lartpërmendura, në raport me të drejtën për të jetuar pranë bashkëshortit.

b/7. Trupi gjykues çmon se çështja e rivlerësimit të subjektit, nëpërmjet ndjekjes së rregullave procedurale dhe kryerjes së hetimit të plotë, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të konfundohet nën pretendimin e cenimit të së drejtës për një jetë familjare. Kjo e fundit gjen zgjidhje si në Kushtetutë, në Kodin e Familjes dhe ligje të tjera të veçanta, të cilët kanë për synim normimin e çdo të drejtë apo detyrimi që bashkëshortët kanë mes tyre, por edhe më gjerë në kuptimin prindëror, mosushtrimin e dhunës në familje, etj., por kurrsesi që kjo e drejtë të prevalojë në raport me një situatë, e cila i shërben subjektit për të vijuar detyrën e saj me sukses, siç është përfundimi i rivlerësimit kalimtar. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit nuk demonstroi arsye apo rrethana konkrete, të cilat reflektonin cenimin e të drejtës së jetës familjare.

b/8. Nga ana tjetër, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë situatë të jashtëzakonshme, pa renditur apo parashikuar të tilla, të cilat do të krijonin pasoja në dëm apo edhe të pariparueshme ndaj subjektit të rivlerësimit. Për më tepër u konstatua se kërkesën për përshpejtim subjekti (nëpërmjet përfaqësueses) e ka ezauruar vetëm në dhjetor të vitit 2021, në një kohë që ka qenë e vetëdijshme se së shpejti përfundonte leja e papaguar, pra, impenjimi i saj për këtë çështje nuk ka treguar konsistencë, por duket se është prezantuar në një moment të caktuar, periudhë e cila deri në përfundimin e lejes së papaguar duket se nuk mund të ishte në favor të hetimit të subjektit.

b/9. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu, se edhe pretendimi i përfaqësues ligjore të subjektit të rivlerësimit për t'u shqyrtuar me prioritet dhe për të pasur një vendim përfundimtar në një kohë të arsyeshme nuk qëndron, për faktin se në komunikimin e tij Komisioni i ka qartësuar subjektit vijimin e procesit të rivlerësimit të saj me prioritet menjëherë me fillimin e hetimit të çështjeve të shortuara në muajin qershor, pra, kur kjo çështje është shortuar.

b/10. Trupi gjykues vlerëson se kërkimi i subjektit për përshpejtim duket të jetë i sforcuar, në kushtet kur për një periudhë relativisht të gjatë ka munguar në kërkime të kësaj natyre ndaj Komisionit për gati një vit prej komunikimit të saj në nëntor të vitit 2020 apo edhe prej komunikimit për herë të parë nga përfaqësuesja në tetor të vitit 2021. Nuk mund të përdoret si argument i suksesshëm pretendimi i depozitimit të kërkesës për përshpejtim në dhjetor të vitit 2021 për faktin se u mësua zgjatja e mandatit të institucionit të Komisionit. Ky moment duket se nuk do të bënte diferencë përballë faktit të afrimit të datës së përfundimit të lejes së papaguar për dy vjet dhënë nga KLP-ja, kur përfaqësuesja shprehet se edhe në një situatë hipotetike, sikur të kishte përfunduar procesi i saj i rivlerësimit, sërish do të ishte larguar, duke zgjedhur ekzistencën e saj pranë bashkëshortit.

b/11. Në tërësi të kësaj problematike, vlerësohet se për sa kohë **zgjedhja** e subjektit të rivlerësimit në raport me ushtrimin e detyrës nuk përfshihet në çështje prioritare sikurse ka

parashikuar legjislacioni i brendshëm i cituar më sipër, proporcionalisht i ka kushtëzuar subjektit pritjen e rivlerësimit minimalisht dhe maksimalisht si çështje prioritare në shortin përkatës, pra, qëndrimin në detyrë deri në përfundim të procesit të rivlerësimit, duke i dhënë më pas të drejtën për të përmbushur zgjedhjen e saj, që padyshim nuk do të shoqërohej me zbatimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

V. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

a. Orientimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

43. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në lidhje me praktikën e gjyqimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në fazën të ndryshme të tij, po kështu dhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj: (i) Presidentin e Republikës; (ii) Këshillin e Lartë Gjyqësor; (iii) Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

44. Si detyrim kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

45. Kolegji i Posaçëm i Apelimit në rastin e subjektit G.S¹⁸, vendim të cilin subjekti e prezanton në pretendimet e saj në këndvështrimin e mosezaurimit nga ky subjekt të lejes së papaguar në raport me sjelljen dhe veprimin e ndryshëm të kryer nga subjekti i rivlerësimit, ka arsyetuar se vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë ndërpret detyrën funksionale që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues çmon që, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit dorëheqjen e tij nuk e ka bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, sikundër edhe nëse do të provohej se shkak i dorëheqjes së tij nga detyra ishte shkak objektiv (shkak shëndetësor, sikurse pretenduar nga subjekti i rivlerësimit), këto fakte vlerësohen pa efekt në drejtim të zbatimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë subjekti i rivlerësimit, si pasojë e dorëheqjes së tij nga detyra që ushtronte në periudhën gjatë së cilës kryhej procesi i rivlerësimit, ka humbur statusin e magjistratit, sipas neneve 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky fakt ka sjellë si pasojë edhe humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio*, në kuadër të parashikimeve të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës.

46. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit (*paraqitur nga përfaqësuesja ligjore*) se në rastin konkret sanksioni i vendosur nga neni G i Kushtetutës, është një sanksion i jashtëzakonshëm, më i rëndë se sa ato që parashikohen në Kodin Penal, kur kryhen vepra penale, për të mos ushtruar një detyrë të caktuar, trupi gjykues konstaton se tashmë ekziston

¹⁸ Përfunduar me vendimin nr. ***, datë 29.7.2020.

një jurisprudencë e konsoliduar e Kolegjit¹⁹, sipas së cilës, masa e kufizimit për të qëndruar 15 vite jashtë sistemit të drejtësisë, është përcaktuar nga një dispozitë kushtetuese, si një periudhë e caktuar, fikse, dhe jo e vendosur në marzhe, rast në të cilin vlerësimi i institucioneve të rivlerësimit për efekt të përcaktimit të periudhës së kufizimit, do t'i nënshtrohej parimit të proporcionalitetit.

47. Trupi gjykues, në çështjen objekt i këtij vendimi, çmon se zbatimi i nenit G²⁰ të Aneksit të Kushtetutës ka ardhur si pasojë e vullnetit të qartë dhe të përvokueshëm të subjektit të rivlerësimit për të mos ushtuar detyrën e prokurorit, vullnet i cili i ka dhënë fund karrierës në sistemin e drejtësisë, trajtuar më poshtë, duke njohur parashikimet e ligjit për pasojat që vijnë në këto rrethana.

b. Verifikimi i vullnetit të pavesuar për dorëheqje

48. Subjekti i rivlerësimit, në datën 7.03.2022²¹ ka deklaruar para Këshillit të Lartë të Prokurorisë heqjen dorë nga detyra e magjistratit për nevojat e saj familjare, për të jetuar pranë bashkëshortit dhe vazhduar jetën familjare.

49. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në kërkesën për dorëheqje të subjektit Esmeralda Ndoci, me vendimin nr. ***, datë 18.3.2022, ka vendosur “Mbarimin e statusit të magjistratit”, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shkak të dorëheqjes së saj. Për këtë vendim, krahas Komisionit, është njoftuar edhe subjekti i rivlerësimit Esmeralda Ndoci.

50. Për sa më sipër, Komisioni vëren se konfirmohet vullneti i pavesuar i subjektit për dorëheqje, pasi znj. Esmeralda Ndoci ka paraqitur dorëheqjen para Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit.

51. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit të KLP-së.

ç. Ligji i zbatueshëm për ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit

52. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

53. Trupi gjykues konstaton se znj. Esmeralda Ndoci ka qenë me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, *ex officio*.

54. Në germën “a” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur ai jep dorëheqjen.

55. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si më poshtë vijon: “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit

¹⁹ Shih vendimet e Kolegjit nr. 17/2019, 38/2020, 41/2020, 6/2021, 17/2021, 4/2022.

²⁰ Referuar vendimit nr. ***, datë 11.3.2022, të Kolegjit.

²¹ Referuar kërkesës së subjektit protokolluar në KLP me nr. *** prot., datë 7.3.2022.

pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit”.

56. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: “1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

57. Vendimi nr. 78, paragrafi 43, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: “[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”.

58. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji për dorëheqje nga statusi i magjistratit. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë ndërprerjen e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Esmeralda Ndoci, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Ndalimin e emërimit të subjektit Esmeralda Ndoci si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 18.5.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka